

NEWSLETTER Nr.1

“BUILDING COMMUNITIES OF KNOWLEDGE FOR COMPETITIVE MSE-S”

Priority Axis 1. Entrepreneurship & Innovation – Sp. Objective 1.3 Territories of Knowledge,
Project No. 1848, Subsidy Contract No BMP1/1.3/1848/2019,
Interreg V-B “Balkan – Mediterranean 2014 – 2020”

FONDACIONI ALBANIAN BESA CAPITAL

... Partner në implementimin e projektit "Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" me akronimin Skills4MSE, në kuadër të “Programit të Bashkëpunimit Ballkanik - Mesdhetar 2014 -2020”.

Partner kryesor i projektit është Qendra për Biznes dhe Zhvillim Kulturor – KEPA.

Partnerët e tjerë përfshijnë:

- Fondacioni ABC, Tiranë, Shqipëri;
- SHKK "FED Invest", Tiranë, Shqipëri;
- Microfond Sofia Foundation, Sofie, Bullgari;
- Universitetin e Maqedonisë (Departamenti i Informatikës së Aplikuar, Komiteti Kërkimor i Universitetit të Maqedonisë (ELKE), Selanik, Greqi;

Në kuadër të implementimit të këtij projekti do të organizohet më datë 27 Shtator 2019, në Hotel Rogner, Tiranë, event i për lancimin e Projektit.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është zhvillimi i një strukture të integruar të mësuarit për vendet e rajonit me qëllim ofrimin e Shërbimeve të Zhvillimit të Biznesit dhe mjeteve të tjera të mbështetjes së biznesit për Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla ekzistuese dhe ato potenciale si fizike ashtu edhe elektronike, me theks në kategoritë e mëposhtme:

- Aftësitë bazë sipërmarrëse
- Aftësitë ndërpersonale
- Aftësitë kompjuterike

Pra, ky projekt është përqendruar në tre vende të rajonit Greqi, Shqipëri dhe Bullgari dhe synon:

- Ndërmarrjet mikro dhe shumë të vogla;
- Start – up;
- Ndërmarrjet sociale;
- Ndërmarrjet që duan të ringrihen pas falimentimit;
- Emigrantë me vendbanim të përhershëm në vendin e zbatimit të projektit.



Projekti

"Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh.

Ky Projekt bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.



Objektivat specifike të projektit janë:

- Inkurajimi i sipërmarrësve ekzistues dhe potencialë për të fituar aftësi / mjete të nevojshme dhe forcimi i kapacitetit me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zgjerimin e aktivitetit drejt tregjeve të tjera dhe prezantimi i inovacioneve në të gjitha fazat e ciklit të biznesit.
- Rritja e nivelit të punësimit në zonën e mbulimit të projektit dhe ndikimi në frenimin e nivelit të largimit nga vendi të njerëzve të kualifikuar.
- Eksplorimi i metodave inovative të trajnimit përmes përdorimit të platformave elektronike, trajnimeve që ofrojnë mbështetje të biznesit dhe shërbime të zhvillimit falas.
- Inkurajimi i sipërmarrjeve sociale, si dhe bizneseve start - up.
- Mbështetja e mikro sipërmarrësve përmes lidhjes së tyre me ofruesit e mikrokredive që ofrojnë mbështetje financiare për kreditimin e bizneseve.
- Shkëmbimi i praktikave më të mira midis rajoneve pjesëmarrëse për të lehtësuar transferimin e njohurive dhe metodologjive për të krijuar biznes të qëndrueshëm.
- Kontribut në realizimin e objektivave të BE-së duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbështetjes së biznesit të emigrantëve dhe sipërmarrësve të mëparshëm të falimentuar dhe atyre që janë në rrezik të falimentimit.

Edukimi dhe trajnimi do t'i mundësojnë sipërmarrësve ekzistues dhe atyre potencialë të fitojnë aftësitë / mjetet e nevojshme dhe kështu të rrisin kapacitetin dhe konkurrencën e tyre, të rriten drejt tregjeve të tjera dhe të prezantojnë inovacionin në të gjitha fazat e ciklit të tyre të biznesit.

Ofrimi i shërbimeve të zhvillimit të biznesit (BDS) për ndërmarrjet mikro dhe të vogla (NVM) ka marrë shumë vëmendje gjatë viteve të kaluara. Kjo vëmendje rezulton nga njohja në rritje e institucioneve të mikrofinancës dhe institucioneve të tjera të përfshirë në zhvillimin e NVM-ve se të varfrit për të krijuar, për të vënë në funksionim dhe rritur bizneset e tyre, kanë nevojë për më shumë sesa qasje në kredi.

Ndërsa financimi vazhdon të luajë një rol kritik në zhvillimin e ndërmarrjeve, ofrimi i shërbimeve jo-financiare, i quajtur edhe BDS, është bërë një komponent gjithnjë e më i rëndësishëm i nismave dhe ndërhyrjeve të zhvillimit të NVM-ve.

Projekti i titulluar "Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" me akronimin Skills4MSEs zbatohet në kuadër të programit "Programi i Bashkëpunimit Ballkanik - Mesdhetar 2014 - 2020" Ky Projekt bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.